

THIRRJE PUBLIKE

PËR KANDIDIM TË GJYQTARËVE NË SKEMËN E DELEGIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 45 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 6 e vijues të “Rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, i ndryshuar, të miratuar me vendimin e tij nr.22, datë 07.02.2019, drejton këtë thirrje publike për kandidim të gjyqtarëve në skemën e delegimit:

1. Gjyqtarët mund të shprehin interesin për t’u komanduar në skemën e delegimit duke kandiduar **në çdo kohë**. Në kushtet kur gjyqtari që kandidon në këtë skemë, shfaq interes për komandim edhe pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar duhet të japë pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive financiare dhe telekomunikimeve vetjake, për vete dhe për të afërmit e tij, sipas përcaktimeve në Ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
2. Gjyqtari që kandidon paraqet dokumentacionin pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës në Këshill, me anë të postës, postës elektronike ose dorazi. Dokumentacioni regjistrohet dhe administrohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Sa më sipër, për më tepër informacion, konsultohuni me ligjet e sipërcituara si dhe me “Rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit” të miratuar me vendimin nr.22, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që gjendet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

FORMULAR KANDIDIMI MBI PJESËMARRJEN NË SKEMËN E DELEGIMIT

TË DHËNAT E GJYQTARIT

1. Emri: 2. Atësia: 3. Mbiemri:
4. Nr. Celulari: 5. E-mail:

GJYKATA KU GJYQTARI KA EMËRIMIN

Shënim: Të plotësohet fusha ku gjyqtari ka emërimin

1. Gjykatë e shkallës së parë:
2. Gjykatë apeli:

TË DHËNA MBI VJETËRSINË

1. Vjetërsia në ushtrimin e detyrës:
2. Vjetërsia në gjykatën
ku ushtron detyrën:

SEKSIONET/DHOMAT NË CILAT GJYQTARI KA BËRË PJESË

Shënim: Të plotësohet/n fusha/t ku gjyqtari ka bërë pjesë duke filluar nga momenti aktual

1. Seksioni/Dhoma: Vite:
2. Seksioni/Dhoma: Vite:

3. Seksioni/Dhoma: Vite:

4. Seksioni/Dhoma: Vite:

INFORMACION MBI MASAT DISIPLINORE

1. Masë disiplinore në fuqi: Po Jo

Nëse po, specifiko llojin e masës dhe vitin kur është marrë kjo masë:

Unë , gjyqtar/e pranë Gjykatës

jap pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i gjyqtarit:

Datë: / /